




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës /Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Komunës nr.02/2015, neni 38 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, dhe nenit 9 i Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve:

F T O H E N I

Që të merrni pjesë në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet me dt.16.09.2020, me fillim në orën 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D I T E


1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Propozim-vendim për Transferim të mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerve, nr.04-400/01-0039833/20, (Raporton Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Kastriot Gashi).



Kryesuesja e KK-së
Znj. Katbardha Haliti



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Skenderaj
Skupština Opštine Skenderaj
Skenderaj Municipal Assembly

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Department of Finance and budget
Direkcija za finansije i bužet

DATË/A:	14.09.2020
PËR/ZA/TO:	Znj. Fatbardha Haliti , Kryesuesë e Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGHT:	z. Bekim Jashari , Kryetari i Komunës
NGA/OD/FROM:	Kastriot Gashi , Drejtori për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Propozim Vendim për Transferim e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerve

Te nderuar,

Duke u bazuar ne në Ligjin për rishikimin e buxhetit Nr. 07/L-14 neni 5 'Rezerva në buxhetet komunale, me vendim të Ministrit mund të bartet tek kategoria e pagave dhe shtesave, në varësi nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Në rast të situatës kur kjo nuk është e nevojshme, rezerva e tillë buxhetore me aprovim të Ministrit mund të bartet te të gjitha kategoritë e shpenzimeve me përjashtim të kategorisë së pagave dhe shtesave, sipas kërkesës dhe vendimit të Kuvendit të Komunës. Këto lëvizje të buxhetit nuk janë subjekt i kufizimeve të transfereve të përfshira në nenin 30 të LMFPP-së apo të nenit 15 të ligjit bazik. Si dhe në shkresën e dorëzuar nga Ministria e Financave me numër 1157 të datës 10.08.2020, Drejtoria për buxhet dhe financa paraqet këtë propozim vendim për Transferim e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezervë sipas kësaj shkrese:

Transfer i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime

Nga nën programet:

Zyra e Kryetarit (16023), shuma prej 785.00 €,

Administrata dhe Personeli (16323), shuma prej 24,900.00 €,

Inspektimet (16645), shuma prej 2,540.00 €,

Zyra e Kuvendit Komunal (16923), shuma prej 197.00 €,

Buxhetimi (17523), shuma prej 285.00 €,

* Infrastruktura Rrugore (18023), shuma prej 5,481.00 €,

Zyra komunale për komunitete dhe kthim (ZLK) (19615), shuma prej 170.00 €,

Bujqësia (47023), shuma prej 792.00 €,

Planifikimi I zhvillimit ekonomik (48023), shuma prej 534.00 €,

Shërbimet e gjeodezisë (65315), shuma prej 784.00 €,

Planifikimi mjedisor dhe Inspeksioni (66620), shuma prej 440.00 €,

Administrata e shëndetësisë (73032), shuma prej 9,139.00 €,

Shërbimet e shëndetësisë primare (74400), shuma prej 98,886.00 €,

Shërbimet Sociale-Skenderaj (75611), shuma prej 5,274.00 €,

Shërbimet kulturore (85023), shuma prej 4,157.00 €,

Administrata (92115), shuma prej 7,855.00 €,

Arsimi parashkollor dhe çerdhet (92650), shuma prej 49,140.00 €,

Arsimi fillor (93660), shuma prej 504,208.00 €,

Arsimi i mesëm (94860), shuma prej 104,755.00 €,

Të transferohen në nën-programet:

Arsimi parashkollor dhe çerdhet (92650), shuma prej 21,846.00 €,

Arsimi fillor (93660), shuma prej 632,886.00 €,

Arsimi i mesëm (94860), shuma prej 144,294.00 €,

Administrata e shëndetësisë (73032), shuma prej 21,296.00 €. Kodi 0099 për menaxhimin e pandemisë Covid19

Transfer i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezerva në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe transfere

Nga nen programet:

Shërbimet e shëndetësisë primare (74400), shuma prej 67,900.00 €,

Të transferohen në nën-programet:

Bujqësia (47023), shuma prej 7,900.00 €,

Shërbimet kulturore (85023), shuma prej 40,000.00 €,

Administrata e shëndetësisë (73032), shuma prej 20,000.00 €,

Arsyetimi

Transferimi i mjeteve financiare nga kategoria “rezervat” në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve tek nen programet Arsim parashkollor dhe çerdhet (92650), Arsim fillor (93660) dhe Arsim i mesëm (94860) në shumë prej 799,026.00 euro, behet me qëllim të mbulimit të obligimeve për shujtave sipas Kontratës Kolektive të lidhur në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut, me datën 18.04.2017, kapitullit IV Rregullat e përgjithshme dhe pagat, neni 35 paragrafi 7, “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një dite punë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore*”. Mos realizimi i këtyre obligimeve kontraktuale nga Drejtoria e Arsimit, përmes këtij transferi Buxheti i Komunës Skenderaj do të dëmtohet me rreth 320,000.00 euro me shumë, nëse pagesa do të realizoheshin përmes procedurave gjyqësore dhe përmbarimore. Ndërsa transferi në nën programet tjera behet me qëllim të përmbushjes së prioriteteve dhe obligimeve tjera kontraktuale si dhe për menaxhimin e pandemisë Covid19.